



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 17.12.2018

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR STATUSIN E DËSHMORIT TË ATDHEUT”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 17.12.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Spartak Braho.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm z. Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, ka si qëllim njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” të personave, të cilët, me akte të rralla patriotizmi, vetëmohimi dhe

heroizmi, kontribuan në luftën për liri, pavarësi dhe çlirim kombëtar të Shqipërisë deri në dhënien e jetës, si dhe të personave, që kanë dhënë e japin jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, të interesave kombëtare shqiptare dhe në luftën kundër terrorizmit, krimit ndaj jetës së individit, mbrojtjes së pronës publike, si dhe në raste fatkeqësish natyrore, në ndihmë të popullsisë.

Në ndryshim nga parashikimet e ligjit aktual, projektligji i propozuar “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, paraqet risitë e mëposhtme:

1. Zgjerimin e rrethit të subjekteve që përfitojnë statusin e dëshmorit të atdheut.
2. Shtimin e kriterëve që duhet të plotësohen për shpalljen apo njohjen e Statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe shtimin e listës së dokumenteve që janë të vlefshme për të kërkuar shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”.
3. Përfshirjen nga dhënia ose njohja e statusit “Dëshmor i Atdheut”, të personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për krime kundër njerëzimit, për bashkëpunim me pushtuesit e vendit, për veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë si dhe për vrasje me dashje, pas datës 9 maj 1945.
4. Zgjerim të gamës së autoriteteve publike (duke shtuar dhe Këshillin Bashkiak) ku mund të bëhet kërkesa nga familjarët për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, kjo për t’u ardhur në ndihmë familjarëve të dëshmorëve.
5. Përmirësim të procedurave të nderimit të “Dëshmorëve të Atdheut” si dhe mënyrës së menaxhimit të Varrezave të Dëshmorëve dhe të objekteve në nderim të tyre.
6. Parashikimi i rregullave për mbështetjen dhe nxitjen e veprimtarive të organizatave, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre Dëshmorët e Atdheut.
7. Zgjerimin e rrethit të familjarëve për efekt nderimi (jo për trajtim financiar), duke shtuar prindërit e prindërve, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen, njerkun/njerkën, thjeshtri/thjeshtrën, si dhe nipërit dhe mbesat e dëshmorëve të atdheut.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, e cila synon synon të përcaktojë kriteret dhe procedurën për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe të drejtat e përfitimit që rrjedhin nga ky status si dhe të adresojë problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit aktual nr.8607, datë 27.4.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar.

Në fjalën e tij zëvendëministri i Mbrojtjes i Mbrojtjes sqaroi se projektligji i ri “Për statusin e dëshmorit të atdheut” i cili paraqitet si nismë e Këshillit të Ministrave synon ndryshimin në formë dhe përmbajtje të ligjit aktual pasi gjatë zbatimit në praktikë të tij ka lindur nevoja për shtesa dhe ndryshime thelbësore. Ky projektligj është i domosdoshëm pasi do të përcaktojë subjektet përfituese të statusit “Dëshmor i Atdheut”, procedurat për shpalljen ose njohjen e tij si dhe të përfimet që burojnë prej tij.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes sqaruan anëtarët e Komisionit se dekrete dhe vendimeve të dhëna nga organet shtetërore për shpalljen “Dëshmor” përpara hyrjes në fuqi të këtij projektligji, do t’i nënshtrohen procedurës së njohjes/konfirmimit formal, bazuar në aktet dhe dokumentacionin e lëshuar nga organet kompetente shtetërore sipas legjislacionin të kohës në të cilin janë lëshuar dhe nuk do të jenë objekt rishikimi referuar parashikimeve të këtij projektligji.

Një çështjet tjetër e diskutuar në komision lidhet me organet që kanë të drejtën e propozimit për shpalljen dhe njohjen e statusit të dëshmorit të atdheut, që sipas parashikimeve të këtij projektligji janë Këshillat Bashkiak, Këshillat e Qarqeve dhe Prefektët. Në veçanti diskutimi u fokusua në të drejtën e Prefektit për paraqitjen e propozimeve për njohjen/shpalljen e statusit të dëshmorit, duke marrë në konsideratë, kompetencat e Prefektit për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimmarrjes së Këshillave Bashkiak sipas ligjit specifik. Në këtë aspekt, përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes sqaruan se referuar parashikimeve të këtij projektligji Prefekti ka vetëm të drejtën e propozimit të shpalljen “Dëshmorët i Atdheut” dhe se kjo e drejtë nuk përbën një risi të këtij projektligji por zbatohet aktualisht referuar përcaktimeve të ligjit aktual.

Njëkohësisht Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 41/2007 ka arsyetuar se: *“Gjykata Kushtetuese vlerëson se dhënia e së drejtës për të bërë propozim për shpalljen "Dëshmor i Atdheut" edhe prefektit nuk cenon parimet kushtetuese e ligjore që rregullojnë qeverisjen vendore, pasi njohja e Statusit të Dëshmorit të Atdheut është një çështje me rëndësi jo vetëm lokale, por edhe kombëtare, e cila, në disa raste, mund të zgjidhet më mirë me iniciimin e procesit nga organet e pushtetit qendror, përfaqësues i të cilëve është prefekti. Nga ana tjetër, dhënia e kompetencës për të bërë propozim për shpalljen "dëshmor" edhe prefektit nuk kufizon kompetencat e organeve të pushtetit vendor. Kjo e drejtë zgjeron vetëm rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të iniciojnë një procedurë administrative për njohjen e këtij statusi nga Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, i cili mbetet i vetmi organ vendimmarrës.”*

Në këtë aspekt duke vlerësuar argumentet e propozuesit si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, vlerësoi si të argumentuar parashikimin e bërë në variantin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, ku e drejta e propozimit të shpalljes/njohjes së statusit të Dëshmorit të Atdheut t’i njihet edhe Prefektit së bashku me Këshillin Bashkiak dhe Këshillin e Qarkut.

IV. REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

Bazuar në çështjet e parashtruara, pyetjet e anëtarëve të komisionit dhe përgjigjet e dhëna nga përfaqësuesit e ministrisë propozuese si dhe nga diskutimi nen për nen i projektligjit, i propozojmë Komisionit përgjegjës sa më poshtë vijon:

1. Në përcaktimin e kategorive të personave që përjashtohen nga përfitimi i statusit të dëshmorit të atdheut, sugjerohet të vlerësohet mundësia e shtimit të një paragrafi, në të cilin

- të parashikohet përjashtimi nga përfitimi i statusit të Dëshmorit të Atdheut, në rastet e ndalimeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të nxjerra pas Luftës së Dytë Botërore.
2. Në përmbajtjen e projektligjit rekomandohet të unifikohet, terminologjia e përdorur dhe të redaktohet përmbajtja e projektligjit nga pikëpamja e teknikës legislative.

V. RIFORMULIME NEN PËR NEN

Në **nenin 2** fjala “të jashtëzakonshëm”, sugjerohet të hiqet.

Në **nenin 3** fjala “të ndjerët”, sugjerohet të hiqet.

Neni 4

- a. Në pikën 1 sugjerohet që fjalët “person fizik” të zëvendësohen me fjalët “individ”. Kjo duke marrë në konsideratë faktin, që termi person fizik referuar legjislacionin tregtar dhe për regjistrimin e biznesit i referohet personave që kryejnë aktivitet tregtar.
- b. Përkufizimet e termave në këtë nen të renditen sipas rendit alfabetik.

Në **neni 5** shkronja “i”, fjalët “që bien”, sugjerohet të zëvendësohet me fjalët “të rënë”.

Neni 8

Pika 3 sugjerohet të hiqet pasi përmbajtja e saj propozohet të integrohet me parashikimet e nenin 9 pika 2 sipas propozimeve të mëposhtme.

Ky propozim të pasqyrohet edhe në nenin 24 pika 3, të projektligjit ku parashikohet nxjerrja e akteve nënligjore.

Neni 9

- a. Pika 1 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” mund të paraqitet nga përfaqësues të familjes së të ndjerit, për të cilin kërkohet që të shpallet ose të njihet “Dëshmor i Atdheut”, ose përfaqësues të autorizuar të organeve shtetërore, organizatave të dëshmorëve të atdheut dhe shoqërisë civile ose nga çdo deputet ”.

Shtesa e propozuar për subjektet kërkuese, sugjerohet të refeflektohet edhe në pikën 6 të nenit 4 dhe kudo ku është përdorur në përmbajtjen e këtij projektligji.

- b. Pika 2 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Formati i kërkesës, llojet e dokumenteve, që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre përcaktohen me udhëzim të kryetarit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Neni 10

a. Pika 3 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Rregullat e detajuara për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimin e Komisionit Qendror, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve nga shoqëria civile në këtë Komision, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”

b. Pika 7 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“7. Komisioni Qendror raporton para Këshillit të Ministrave, për përmbushjen e detyrave të parashikuara në këtë ligj të paktën 1 herë në vit, ose sa herë që kërkohet prej tij”.

Neni 13

Pika 8 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“8. Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe trajtohen si monument kulture, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin publik të varrimit dhe për trashëgiminë kulturore.”

Neni 15

a. Në pikën 1 pas fjalëve “... dhe ruhen...” sugjerohet të shtohet shprehja “ sipas përgjegjësisë përkatëse...”.

b. Në pikën 2 shprehja “interesa të lartë shtetëror”, sugjerohet të zëvendësohet me shprehjen “interesi publik”.

Neni 18

a. Në pikën 3 i sugjerohet komisionit përgjegjës të vlerësojë heqjen e shprehjes “...dhe kur bashkëshortja/bashkëshorti i Dëshmorit të Atdheut martohet përsëri.” Kjo pasi ky parashikim i vendos personat në pozita pabarbartë duke sjellë deformimin e qëllimit për të cilin jepet shpërblimi financiar.

b. Pika 4 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“4. Shpërblimi familjar tërhiqet nga secili familjar sipas, sipas pjesës që i përket, nga kujdestari ligjor për fëmijët nën moshën 18 vjeç ose nga përfaqësuesi i pajisur me prokurë”.

Neni 23 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 23

Ankimi

1. Kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, që refuzon të pranojë kërkesën ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për refuzimin apo nga data e mbarimit të afatit ligjor për marrjen në shqyrtim të kërkesës;

2. Kundër vendimit të Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe në rastet kur ky komision nuk shprehet brenda afateve të përcaktuar në pikën 6, të nenit 10, të këtij ligji subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë gjykatës kompetente, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

Neni 24

Në pikat 1, 2 3, dhe 4 të këtij neni, shprehja “brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji” të zëvendësohet me shprehjen “brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

VI. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

SPARTAK BRAHO

ULSI MANJA